

Kategoria Superiore/ Lushnja -Tirana 2-1

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 30 Nentor 2013 17:28



Megjithë perpjekjet e Tiranes dhe volumin e lojes se krijuar ne favor te tyre, skuadrae bardh e blu nuk ariti qe te shfrytezonte epersine numerike qe krijoi ndaj ekipit vendas Lushnja per te arritur nje rezultat pozitiv. Lushnja fitoi nje takim shume te rendesishem, edhe pse shumicen e lojes u mbrojti per te ruajtuar avantazhin e krijuar ne pjesen e pare. Vendorsja ne portee Sejdos, ndikoi edhe ne golate shenuar nga vendasit. Canka dhe Mihani i dhane epersine e dyfishte Lushnjes, avantazh qe u shkurtua nga goli i shenuar prej Pashajt. Ne pjesen e dyte, epersia numerike e Tiranes dhe intensiteti i krijuar nga kryeqytetasit nuk ishte i mjaftueshem per te thyer mbrojtjen e blinduar te vendasve. Lushnja arriti te fitoje nje trepikesh me shumevlera, ndersa Tirana vazhdon te mbetet ne fund te renditjes.